



**Republika e Kosovës – Republika Kosova**  
**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**  
**Izborni Panel za Žalbe i Predstavke**

**A nr. 330/2013**

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Nehat Idrizi kryesues, Nenad Lazić dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Partia e Ashkalive për Integrim (PAI) dega në Ferizaj, paraqitur kundër subjektit politik Partia Demokratike e Ashkalive të Kosovës (PDAK) dega në Ferizaj, për shkak të dëmtimit të posterave, në seancën e panelit të mbajtur me 25.10.2013, mori këtë:

**VENDIM**

**HIDHET si e pasafatshme** ankesa e subjektit politik Partia e Ashkalive për Integrim (PAI), dega në Ferizaj.

**Arsyetim**

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 23.10.2013, nga subjekti politik PAI dega në Ferizaj, në të cilën theksohet se me datën 12.10.2013, Qazim Rrahmani me disa të tjerë kanë dëmtuar posterin e kryetarit të PAI-së në Ferizaj, i cili poster ishte i vendosur në fshatin Dubravë.


PZAP-i, pasi që shqyrtoi afatshmerinë e ankesës gjeti se:

**Ankesa është e pasafatshme**

PZAP-i konsideron se ankesa në fjalë është e pasafatshme pasi që neni 3.4 i Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it parasheh që për të gjitha çështje që nuk lidhen drejtpërdrejt me votimin dhe numërimin ankesa duhet të dorëzohet në PZAP brenda 72 orëve nga shkelja e pretenduar, andaj ngjarja për të cilin pretendon pala ankuese pretendon se ka ndodhur me datën 12.10.2013, ndërsa ankesa në PZAP është dorëzuar me datën 23.10.2013 çka nënkupton se ka kaluar afati i paraparë prej 72 orë për dorëzimin e ankesës në PZAP, prandaj në kuptim të nenit 3.4 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it si dhe nenit 118.1 të LZP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrresa**

Anr. 330/2013 më datën 25.10.2013



**Kryesuesi i Panelit  
Nehat Idrizi**

Kshillë Juridike: PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.*